

LIGJ
Nr. 26/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FORCAVE SHUMËKOMBËSHE DHE
VËZHguesve PËR Pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të
Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 23.3.2023.

**Shpallur me dekretin nr.53, datë 6.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FORCAVE SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHguesve PËR Pjesëmarrjen e Forcave
TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË NË FORCAT SHUMËKOMBËSHE DHE
VËZHguesve NË SINAI**

Preambulë

Këshilli i Ministrave i Republikës të Shqipërisë (në vijim i referuar si “Shqipëria”) dhe Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (në vijim të referuara si “FSHV”), (në vijim të referuar bashkërisht si “Palët”),

Duke marrë parasysh gatishmërinë e Shqipërisë për të ofruar personel për FSHV-në dhe për të mbështetur misionin e saj të shprehur me Traktatin e Paqes ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, të datës 26 mars 1979, (në vijim i referuar si Traktati) dhe protokollin e saj të datës 3 gusht 1981 (në vijim i referuar si “protokolli”),

Në bazë të ftesës së drejtorit të përgjithshëm të FSHV-së përmes përgjegjësive që i janë dhënë nga protokolli,

Kanë rënë dakord për sa vijon:

PJESA I PËRBËRJA DHE MISIONI

1. Shqipëria do të sigurojë personel (në vijim i referuar si “personeli i caktuar”) dhe pajisje, siç parashikohet këtu, për të shërbyer në FSHV. Personeli i caktuar do të vendoset në FSHV në Sinai, Republikën Arabe të Egjiptit.

2. “Personeli i caktuar” fillimisht do të përbëhet nga një oficer, komandanti i kontingjentit i cili do të shërbejë vendosje/dislokime njëvjeçare në Njësinë e Policisë Ushtarake të Forcave të FSHV-së (NJPUF) si Provost Marshall (OF4-Major) dhe dy anëtarë shtesë personeli që do të jenë të caktuar në NJPUF si Oficer Urdhri Provost (rreshter major ose oficer urdhri) dhe një Hetues (E6-Rreshter). Numri i personelit të caktuar dhe funksionet e tyre në vijim mund të rregullohen me marrëveshje të ndërsjellë. Komandanti i kontingjentit do të ketë qasje të drejtpërdrejtë me komandantin e forcës për çeshtjet operative që lidhen me pjesëmarrjen e personelit të caktuar në FSHV.

3. Përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, personeli i caktuar do të shërbejë një turne njëvjeçar, të pashoqëruar. Palët do të konsultohen dhe do të përcaktojnë reciprokisht planin e rotacionit të personelit të caktuar për të siguruar një mbivendosje të duhur të personelit me rotacion për qëllime trajnimi dhe vazhdimësie.

4. Personeli i caktuar do të dislokohet dhe do të funksionojë pasi Shqipëria të ketë përfunduar procedurat e nevojshme ligjore të brendshme për vënien në fuqi të Marrëveshjes.

PJESA II RREGULLIMET FINANCIARE

1. Shqipëria do të marrë masa që të gjitha pagesat e pagave, shtesave dhe përfitimeve të tjera për personelin e caktuar që normalisht do t’i paguhet personelit ushtarak shqiptar kur të vendoset jashtë vendit. FSHV-ja do të paguajë Shqipërinë për personelin e caktuar me një normë standarde prej 1000 dollarë për person në muaj. Gjithashtu, ka një pagesë ditore prej 2,56 dollarë për person në ditë, e paguar drejtpërdrejt personelit të caktuar në Sinai.

2. FSHV-ja do të sigurojë, pa kosto për Republikën e Shqipërisë, ushqim, akomodim dhe mbështetje për personelin e caktuar në Sinai, brenda zonave të FSHV-ve, si dhe jashtë tyre.

3. FSHV-ja do t’i rimbursojë Republikës së Shqipërisë koston e: a) transportit të personelit të caktuar dhe bagazheve personale deri në 70 kg për personelin që shërben një turne njëvjeçar dhe deri në 45 kg për personelin që shërben një turne gjashtëmuor të detyrës me FSHV-në, me rrugën më të drejtpërdrejtë nga pika e caktuar e nisjes në stacionin e shërbimit të FSHV-së në Sinai dhe mbrapsht; dhe b) një dërgesë një herë deri në 150 kg për armët personale të personelit të caktuar, municionet dhe pajisjet e tjera të specifikuara në pjesën II, paragrafi 4 nga pika e caktuar e nisjes në stacionin e detyrës FSHV në Sinai dhe mbrapsht. Në konsultim me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, FSHV-ja do të bjerë dakord për një tarifë vjetore standarde transporti (TST) për rimbursimin e transportit të personelit të caktuar dhe bagazheve personale të lartpërmendura. Një TST do të llogaritet për çdo vit fiskal të FSHV-së (1 tetor deri më 30 shtator) dhe do të miratohet të paktën dy muaj para (jo më vonë se data 31 korrik) nga fillimi i një viti të ri fiskal të FSHV-së. TST-ja do të bazohet në një mesatare të tarifave ajrore të kuotuar (duke përfshirë taksat dhe tarifat e zbatueshme) të ofruara FSHV-së nga ofruesi i saj i kontraktuar i transportit për vajtje-ardhje, udhëtime të klasit ekonomik në transportuesit tregtarë të planifikuar rregullisht nga pika e caktuar e nisjes për në Tel Aviv, Kajro ose Sharm el Sheikh dhe kthimi për muajt prill, korrik dhe tetor. Pretendimet/pagesat për udhëtim vetëm vajtje do të bazohen në gjysmën e TST-së. Përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, pika e caktuar e nisjes/kthimit është Tërana. Ministria e Mbrojtjes e

Republikës së Shqipërisë do të konsultohet, gjithashtu, me FSHV-në në lidhje me mënyrën e transportit për dërgesën njëherëshe të përmendur këtu.

4. Shqipëria do të sigurojë dhe mirëmbajë, pa kosto për FSHV-në, armët personale, municionet, pajisjet e komunikimit për komunikimet kombëtare, uniformat, helmetën mbrojtëse dhe parzmoren e trupit, si dhe pajisjet e mjetet e tjera personale që kërkohen nga personeli i caktuar për kryerjen e misionit të tyre në FSHV. Personeli i caktuar do të jetë i armatosur me armë individuale në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe i pajisur gjatë gjithë kohës me rezerva municioni prej dy mbushjesh bazë FSHV për armë dhe një sasi shtesë trajnimi rreth gjysmës së një mbushjeje bazë FSHV për armë. Mbushja bazë FSHV është 200 fishekë për një pushkë dhe 26 fishekë për një pistoletë. Të gjitha armët personale, municionet dhe pajisjet e tjera të lartpërmendura për t'u vendosur nga Shqipëria, do të njoftohen nga Shqipëria të paktën katër javë përpara vendosjes së planifikuar në shtabin e FSHV-së, e cila mund të vendosë kufizime për këtë vendosje/dislokim dhe që do të sigurojë dërgesa, duhet të kryhet në përputhje me rregulloret e FSHV-së dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse të Republikës Arabe të Egjiptit.

5. Në rast nevojë në lidhje me orientimin dhe përgatitjen për vendosjen/dislokimin e parë të personelit të caktuar, FSHV-ja do të sigurojë transport, pa kosto për Republikën e Shqipërisë, për një ekip paraprak të një numri të rënë dakord të personelit shqiptar nga Tirana në Sinai dhe kthim, si dhe transportin lokal, ushqenin dhe akomodimin brenda vendeve të FSHV-ve.

6. Shlyerja e të gjitha krediteve ose rimbursimeve nga FSHV-ja sipas kësaj pjese, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, do të bëhet në dollarë amerikanë dhe do të bëhet mbi baza tremujore pas paraqitjes nga ose pranë FSHV-së të një fature të përgatitur në përputhje me këtë Marrëveshje. Faturat do të paraqiten brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik dhe pagesa do të kryhet brenda 30 ditëve nga marrja e faturës.

7. Pa cenuar pjesën II, paragrafi 8, me paraqitjen nga Shqipëria në kanalin diplomatik të një pretendimi plotësisht të dokumentuar dhe të vërtetuar, FSHV-ja do të rimbursojë Shqipërinë për pjesën proporcionale të FSHV-së për çdo pagesë që Shqipëria kryen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë në rastin e vdekjes, lëndimit ose paaftësisë së personelit të caktuar që i atribuohet shërbimit në FSHV. Në rast se ligjet dhe rregulloret shqiptare kërkojnë pagesa periodike, FSHV-ja do të paguajë një shumë të vetme. Pjesa proporcionale sipas fjalisë së parë dhe shuma e vetme e përgjithshme sipas fjalisë së dytë do të bihen dakord nga Palët.

8. FSHV-ja do të kërkojë rimbursim në situatat që përfshijnë humbjen ose dëmtimin e pronës së FSHV-së që rezulton nga neglizhenca e rëndë ose sjellja jo e duhur e qëllimshme e personelit të caktuar. Për këtë qëllim, FSHV-ja do të informojë Shqipërinë për çdo pretendim të tillë që përfshin personelin e caktuar dhe do të sigurojë dokumentacionin e tyre. Me kërkesë të secilës palë, kurdoherë që është e nevojshme, FSHV-ja dhe Shqipëria do të zhvillojnë konsultime për ndarjen e përgjegjësisë për këto ose pretendime të tjera që mund të lindin dhe do t'i zgjidhin me marrëveshje në kanalet diplomatike.

9. Për pretendimet e mbuluara në pjesën II, paragrafi 8, FSHV-ja dhe Shqipëria do të konsultohen në mënyrë të pranueshme reciprokisht në lidhje me pagesën ose të kompensimit të kreditit.

PJESA III ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

1. Shqipëria do të kërkojë që personeli i caktuar të jetë në përputhje me direktivat, rregulloret dhe urdhrat e FSHV-ve.

2. Duke iu referuar paragrafit 6 të shtojcës së protokollit të Traktatit të Paqes, kuptohet se personeli i caktuar do të vendoset nën kontrollin operacional të Komandantit të Forcave të FSHV-së, Komandanti i Forcave të FSHV-së do t'i sigurojë komandantit të kontingjentit shqiptar urdhra të një natyre operationale në përputhje me zinxhirin komandues të krijuar nga komandanti i Forcave të FSHV-së në zbatim të protokollit.

3. FSHV-ja do t'i sigurojë, pa kosto për Shqipërinë, personelit të caktuar kujdesin ambulator mjekësor dhe dentar rutinë (në të njëjtën masë siç i ofrohet personelit tjetër të FSHV-së), Stabilizim urgjent në objektet e trajtimit të FSHV-ve në Sinai, referim tek objektet mjekësore të nivelit më të lartë në Republikën Arabe të Egjiptit ose Izraelit (në vijim të referuara si "Shtetet Pranuese") dhe/ose rikthimin mjekësor, sipas rastit sipas rregullave dhe praktikës së FSHV-ve.

4. Shqipëria do të sigurojë që personeli i caktuar të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja mjekësore dhe dentare përpara se të dërgohet në FSHV, duke përfshirë vaksinimin kundër COVID-19, duke përdorur një vaksinë të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Jo më vonë se gjashtë javë përpara vendosjes së personelit të parë të caktuar, FSHV-ja duhet t'i njoftojë Shqipërisë kushtet mjekësore dhe dentare që pengojnë dërgimin në FSHV dhe imunizimet që duhet të marrë personeli i caktuar përpara vendosjes/dislokimit. Një njoftim i tillë mund të përditësohet herë pas here.

5. Nëse personeli i caktuar, i cili është vendosur/dislokuar pas njoftimit të specifikuar në pjesën III, paragrafi 4 është dhënë, kërkon kujdes mjekësor ose dentar ose rikthim, për shkak të:

a) një kushti të specifikuar nga FSHV-ja në njoftimin e përmendur në pjesën III, paragrafi 4 dhe ekzistues përpara vendosjes/dislokimit të tyre; ose

b) mosmarrjes së imunizimit nga personeli i caktuar të specifikuar nga FSHV-ja në njoftimin e përmendur në pjesën III, paragrafi 4,

FSHV-ja mund të kërkojë rimbursim nga Shqipëria për kostot që lidhen me këtë kujdes mjekësor ose dentar ose kthimin.

6. FSHV-ja do të jete përgjegjëse dhe do të rimbursojë kostot e kthimit në Shqipëri të eshtrave të personelit të caktuar të ndjerë.

7. a) "Itinerari FSHV" nënkupton itinerarin më të drejtpërdrejtë nga pika e caktuar e nisjes në stacionin e detyrës FSHV në Sinai dhe, në përfundim të detyrës me FSHV-në, nga stacioni detyrës FSHV në itinerarin më të drejtpërdrejtë në pikën e caktuar të kthimit.

b) Personeli i caktuar do të konsiderohet se ka hyrë në shërbim që i atribuohet FSHV-së që nga koha kur largohen nga pika e caktuar e nisjes, me qëllim të marrjes së detyrës me FSHV-në. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe reciprokisht, personeli i caktuar që devijon, për arsye personale ose kombëtare, zyrtare (duke përfshirë sëmundjen për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 4), nga Itinerari FSHV, për aq kohë sa janë në atë devijim, nuk do të konsiderohen në shërbim që i atribuohet FSHV-së. Personeli i caktuar, udhëtimi i të cilit për të marrë detyrën në FSHV, fillon në një vend të ndryshëm nga pika e përcaktuar e nisjes, nuk do të konsiderohet se ka hyrë në shërbim që i atribuohet FSHV-së derisa të jenë raportuar për detyre tek autoritetet e FSHV-së në një nga Shtetet Pranuese.

c) Personeli i caktuar, pas kryerjes së detyrës me FSHV-në, do të ndërpresë shërbimin që i atribuohet FSHV-së në përputhje me sa vijon:

i. në lidhje me personelin e caktuar me një stacion shërbimi në vazhdim në Shqipëri, i cili udhëton drejtpërdrejt në Shqipëri, shërbimi që i atribuohet FSHV-së do të përfundojë me mbërritjen në Shqipëri;

ii. në lidhje me personelin e caktuar me një stacion në vazhdim jashtë Shqipërisë, i cili udhëton drejtpërdrejt në atë vend, shërbimi që i atribuohet FSHV-së do të përfundojë me mbërritjen në çdo pikë në atë vend;

iii. në lidhje me personelin e caktuar i cili, për arsye leverdie personale, kombëtare ose zyrtare (përfshirë sëmundjet për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 5) vonon mbërritjen në vendin e stacionit të ri të detyrës, shërbimi që i atribuohet FSHV do të përfundojë me nisjen nga secili prej Shteteve Marrëse; dhe

iv. në lidhje me personelin e caktuar, i cili, për arsye leverdie personale kombëtare ose zyrtare (përfshirë sëmundjet për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 5), vonon nisjen nga Shtetet Pranuese, shërbimi që i atribuohet FSHV-së do të përfundojë me nisjen nga stacioni i shërbimit të MPF-së.

d) FSHV-ja nuk do të jetë përgjegjëse për mbërritjen me vonesë në stacionin e mëtejshëm të detyrës së çdo personeli të caktuar që devijon nga itinerari i FSHV-së.

e) Çdo kosto shtesë që rezulton nga devijimet e itinerarit të FSHV-së, duke përfshirë devijimet si rezultat i një sëmundeje për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 5, do të përballohet nga Shqipëria ose individi.

8. a) Shqipëria mund t'i ofrojë personelit të caktuar, me shpenzimet e veta, lidhje të drejtpërdrejta radio ose lidhje të tjera komunikimi dhe pajisje shoqëruese. Zbatimi i vendimit për këtë qëllim do të koordinohet me komandantin e Forcave të FSHV-së. Shmangia e çdo ndërhyrjeje në komunikimet e FSHV-ve është përgjegjësi e Shqipërisë. Frekuencat (përfshirë frekuencat satelitore) duhet të përcaktohen reciprokisht ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit. Dëshmia e një koordinimi të tillë duhet t'i jepet FSHV-së përpara përdorimit të çdo radioje, pajisjeje satelitore ose transmetuesi tjetër.

b) Objektet e komunikimit të FSHV-ve mund të përdoren nga Komandanti shqiptar për komunikimet me Shqipërinë që lidhen me pjesëmarrjen shqiptare, kur ky përdorim është pa kosto për FSHV-në, në bazë të hapësirës së disponueshme. Komandanti i Forcave të FSHV-së mund të autorizojë komunikime me kosto për FSHV-në në rast emergjence personale ose për arsye humanitare ose pas konsultimeve me shtabin e FSHV-së në Romë, për FSHV-në.

c) Me përjashtim të çështjeve operationale të trajtuara në pjesën I, paragrafin 42, shtabi i FSHV-së në Romë, nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë, do të jetë kanali për të gjitha komunikimet zyrtare ndërmjet FSHV-së dhe Shqipërisë.

9. a) Shqipëria mund të hyjë në marrëveshje me autoritetet postare të Shteteve Marrëse dhe/ose shteteve të tjera pjesëmarrëse për dërgesat e saj postare dhe postës së paketave drejt dhe nga personeli i caktuar.

b) Posta për personelin e caktuar mund të postohet gjithashtu nëpërmjet kanaleve të postës ushtarake të Shteteve të Bashkuara në FSHV në adresën e mëposhtme ose në një adresë tjetër që FSHV-ja mund t'i njoftojë Shqipërisë me shkrim herë pas here:

Emri [në tekstin latin]

FSHV Kampi Jugor/Kontingjenti shqiptar

Njësia 31530

APO AE 09804

c) Posta e adresuar rregullisht personelit të caktuar dhe e marrë në adresën e mësipërme do të transportohet nga FSHV-ja tek komandanti i kontingjentit shqiptar, ose i caktuari i tij/saj, në Sinai. Për letrat dhe pakot dalëse, tarifat postare në SHBA shiten në Kampin Jugor.

10. Kërkesat zyrtare të kontingjentit për mallra ose shërbime nga burimet e shtetit pranues, edhe nëse bëhen me shpenzimet e personelit të caktuar, do të prokurohen përmes kanaleve të prokurimit të FSHV-ve, përveç rasteve kur mund të përcaktohet më parë reciprokisht.

11. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret shqiptare, komandanti i kontingjentit shqiptar do të ndihmojë FSHV-në në çdo hetim të çdo akti që i shkakton humbje FSHV-së, përfshirë dëmtimin e pajisjeve, automjeteve ose pronës tjetër në pronësi të

FSHV-së që rezulton nga shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve të Shqipërisë ose rregulloreve apo urdhrave të FSHV-ve; ky asistim mund të përfshijë, kur është e përshtatshme, veprime për të disiplinuar personelin në fjalë dhe për të garantuar kthimin e FSHV-së duke rikuperuar koston e një humbjeje ose dëmi të tillë nga personeli në fjalë.

12. Kurdoherë që Shqipëria heton ndonjë personel të caktuar sipas ligjeve dhe rregulloreve të Shqipërisë kur supozohet se ka shkaktuar dëme në lidhje me pronën e FSHV-së, Shqipëria do të japë informacion mbi zgjidhjen e çdo rasti të tillë me kërkesë të FSHV-së.

13. Shqipëria ka të drejtë të kryejë hetime aksidentale, disiplinore ose hetime të tjera në lidhje me ngjarje që lidhen me personelin e caktuar ose pronën e tyre në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë. Këto hetime do të koordinohen me çdo hetim paralel të FSHV-ve. FSHV-ja do të asistojë Shqipërinë në kryerjen e hetimeve.

14. Personeli i caktuar do të kthehet, me kërkesë të Shqipërisë, përpara përfundimit të turneut të detyrës. Në këtë rast, FSHV-ja mund të kërkojë që të sigurohet në kohë një zëvendësim përshtatshëm, në mënyrë që të ndodhë mbivendosja ndërmjet largimit të personelit të caktuar të kthyer dhe mbërritjes së personelit të ri të caktuar. Shqipëria pranon se ky rast duhet të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe do ta shqyrtojë me kujdes një kërkesë të tillë për zëvendësim.

15. Kthimi i personelit të caktuar në Shqipëri për arsye disiplinore nga Komandanti i Forcave të FSHV-së do të koordinohet me drejtorin e përgjithshëm. Shqipëria do të marrë masat e duhura për të siguruar disponueshmërinë e këtij personeli të caktuar në lidhje me çdo hetim apo procedim ligjor.

16. Në përputhje me paragrafin 11(c) të shtojcës së protokollit të Traktatit të Paqes, Shqipëria do të marrë masat e nevojshme për të garantuar disiplinën e duhur të personelit të saj të caktuar dhe për të ushtruar juridiksion në lidhje me çdo krim ose shkelje që mund të kryhet nga personeli i saj i caktuar. Shqipëria do të njoftojë FSHV-në për kushtet e çdo marrëveshjeje plotësuese me një shtet marrës në përputhje me paragrafin 11(d) të shtojcës së protokollit të Traktatit të Paqes.

17. Në rast kthimi të çdo personeli të caktuar në Shqipëri për arsye disiplinore ose administrative shqiptare, FSHV-ja mund të kërkojë rimbursim ose kompensim krediti nga Shqipëria për kostot që lidhen me kthimin.

PJESA IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo Marrëveshje mund të plotësohet ose ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve.

2. Palët synojnë të ndërmarrin hapat e duhur të mëtejshëm, në përputhje me ligjin shqiptar, për të zbatuar privilegjet dhe imunitetet e organizatës ndërkombëtare që i janë dhënë FSHV-së nga protokollit i Traktatit të Paqes në Republikën e Shqipërisë.

3. Çdo dallim ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me negociata ndërmjet Palëve.

4. Shqipëria është e ndërgjegjshme për rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimit në njësitë me FSHV. Rrjedhimisht, personeli i caktuar nuk do të tërhiqet pa njoftim të duhur paraprak për drejtorin e përgjithshëm të FSHV-së që do të konsiderohet në përputhje me dispozitat e mëposhtme për kohëzgjatjen dhe përfundimin. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë në fuqi për një vit (përveç rastit kur Shqipëria dhe FSHV-ja bien dakord reciprokisht për të zgjatur këtë Marrëveshje), Shqipëria jep një njoftim me shkrim për gjashtë muaj mbi synimin e saj për t'u tërhequr nga kjo Marrëveshje, ose deri në momentin kur qeveritë e Izraelit dhe Egjiptit mund të bien dakord reciprokisht për të përfunduar turneun e FSHV-së.

5. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga FSHV-ja të njoftimit nga Shqipëria se Shqipëria ka përfunduar procedurat e nevojshme të brendshme ligjore për vënien në fuqi të Marrëveshjes.

6. Kjo Marrëveshje është nënshkruar në Tiranë, më datë 8 nëntor 2022, në katër kopje origjinale, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËSSHQIPËRISË

Nënshkrimi:

Emri:

NË EMËR TË FORCAVE SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE

Nënshkrimi:

Emri: